



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1571 Prot.

Tiranë, më 26. 11 2018

VENDIM Nr. 251, datë 21.11.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11, datë 21.11.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC OLBEN" Bashkia Gramsh*-subjekti "ELTEX" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC OLBEN" Bashkia Gramsh*-subjekti "ELTEX" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Taulant Rama.
2. Subjekti "ELTEX" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC OLBEN" Bashkia Gramsh, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu". Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@usha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@usha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)